




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ref: 1905/597/BA/ah
Nr. 03/2019

Bordi për Ankesa, i përbërë nga Avdyl Hyseni-kryetar dhe Musa Dragusha e Ilaz Rudaku-anëtarë, duke vendosur lidhur me Ankesën Nr. Ref:1904/564/BA/ah të datës 26.04.2019, të parashtruesit “TE 7” përfaqësuar nga avokati Arjanit Koci, të paraqitur ndaj Vendimit Nr. 2019/18 të datës 29.03.2019, me nr. Ref. 1903/367/KPM/mf të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në seancën e mbajtur me datë 10.05.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar Ankesa Nr. Ref. 1904/564/BA/ah e datës 26.04.2019 e parashtruesit “TE 7”.

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr. 2019/18 i datës 29.03.2019, me Nr. Ref. 1903/367/KPM/mf, të Komisionit të Pavarur të Mediave.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Nr.2019/18 të datës 29.03.2019, me Nr. Ref: 1903/367/KPM/mf, Televizionin TE 7 si Palë përgjegjëse, e ka sanksionuar me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave për shkeljet e nenit 7 paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. Gjithashtu e ka obliguar që gjatë trajtimit të ngjarjeve të ngjashme të ketë kujdes të shtuar dhe të sigurohet se një gjë e tillë nuk do të përsëritet në të ardhmen.

Kundër këtij Vendimi në afatin e përparë ligjor Televizioni TE 7 me datë 26.04.2019 ka parashtruar ankesë pranë Bordit për Ankesa, duke kundërshtuar Vendimin Nr. 2019/18 të datës 29.03.2019, me Nr. Ref. 1903/367/KPM/mf, të Komisionit të Pavarur të Mediave me të cilin është shqiptuar Vërejtje Palës përgjegjëse, duke pretenduar se ky Vendim është i pavend dhe i paqëndrueshëm, me propozim që Bordi për Ankesa në KPM të aprovojë ankesën si të bazuar, të shfuqizojë Vendimin kontestues dhe të merr vendim në favor të Palës përgjegjëse.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datë 10.05.2019 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese "TE 7", si dhe ka analizuar të gjitha provat tjera të cilat kanë rezultuar me marrjen e Vendimit Nr. 2019/18 të datës 29.03.2019, me Nr. Ref. 1903/367/KPM/mf, të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa konstaton se pretendimet e Palës ankuese lidhur me gjendjen faktike dhe shkeljen ligjore nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave janë të pa bazuara, sepse Komisioni i Pavarur i Mediave me rastin e marrjes së vendimit të kundërshtuar e ka vërtetuar plotësisht gjendjen faktike, drejtë ka aplikuar dispozitat materiale dhe procedurale që rregullojnë fushën e KPM-së.

Andaj Bordi për Ankesa, nga të theksuarat më lartë e bazuar në nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 i Rregullores Nr. BA 2017/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimitisht si në dispozitivin e këtij vendimi.

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Vendimi mund të inicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve dhe
- Arkivit të KPM-së.



Avdyl Hyseni

(Signature)
Kryetar i Bordit për Ankesa